



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:003799

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05624291

P.nr.163/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. Ll. nga Prishtina, të cilin e mbronë Arlind Jupolli av. në Prishtina, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.574/22 të dt.06.01.2023, për shkak të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafin 2 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor, publik, të mbajtur me datën 24.04.2024, në prani të prokurorit së shtetit Besnik Jakupi, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij Arlind Jupolli av. nga Prishtina, në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

M. LL., i lindur me dt..... në P., me vendbanim Rr. "T." nr.... (M. e M.), nga i ati R. dhe nënës M., e gjinisë G., me nr.personal ..., i martuar, ka të kryer Shkollen e Mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

II. I pandehuri M. Ll. me datën 05.07.2022, rreth orës 05:30 minuta, në Fshatin Sh., në vendin e qujtur K., i pandehuri M. Ll. pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarin C. G., i pandehuri M. Ll. ka përdor armë në mënyrë të paautorizuar në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, ashtu që i pandehuri i lartëcekur M. Ll. me qëllim të kërcënimit dhe frikësimit, me pushkën e gjuetisë me numër serik:... e kalibrit 12 mm, të cilën e ka marr në dorë duke shtënë një herë në ajrë, duke fyer me fjalë fyese duke e sharë me nënë të dëmtuarin C. G. dhe duke i thënë ndërpreje punën dhe largohu nga këtu të dëmtuarit C. G., i cili ishte me djalin e tij të moshës 12 vjeçar, duke prerë dru në mal dhe më pas i dëmtuari C. G. së bashku me djalin e tij të moshës 12 vjeçar është larguar nga vendi i ngjarjes, me ç'rast i pandehuri i lartëcekur M. Ll. i ka shkuar mbrapa të dëmtuarit C. G. dhe djalit të tij rreth një distancë 50 metra dhe më pas i pandehuri M. Ll. është larguar nga vendi i ngjarjes,-

-me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së,

II. I pandehuri M. Ll. me datën 05.07.2022, rreth orës 05:30 minuta, në Fshatin Sh., në vendin e qujtur K., ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar pushkën e gjuetisë me numër serik:... e kalibrit 12 mm, e cila pushkë e gjuetisë i është gjetur dhe sekuestruar

të pandehurit M. Ll. nga ana e policisë, e të cilën pushkë gjuetije i pandehuri M. Ll. e ka mbajtur në posedim dhe kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët,-

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 42, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 71 par. 1 nënpar. 1,3 të KPRK-së dhe neni 367 par. 2 të KPRK-së dhe nenit 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE ME KUSHT

Për veprën penale si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) vit nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën konform nenin 50 të KPRK-së dënimi me kusht do të revokohet dhe

Me dënim me gjobë në shumën prej 500.00-€ (pesëqindeuro),

Për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Konform nenin 76 par.1 dhe 2 nënpar.2.5 të KPRK-së, të akuzuarit gjykata i shqipton:

DËNIM UNIK ME KUSHT DHE ME GJOBË

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me burgim konform nenit 50 të KPRK-së do të revokohet dhe

Me dënim me gjobë në shumë prej 500 euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumën prej 20-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendit- pushkën e gjuetisë me numër serik:..... e kalibrit 12 mm dhe Detyrohet Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Lipjan, që arma e konfiskuar nëse është e vjetruar apo e dëmtuar ta shkatërroj – asgjësoj ose në të kundërtën nëse është funksionale të kalohet në Ministrinë e Punëve të Brendshme-Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.574/22 të dt.06.01.2023, e ka akuzuar të akuzuarin M. Ll. nga P., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafin 2 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajsisë është bërë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajsisë ta pranoj si të bazuar. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbete në tërsi pranë aktakuzës të ngritur ndaj të akuzuarit dhe nga pranimi i fajsisë i cili është aprovuar nga gjykata është vërtetuar gjendja faktike si në aktakuzë

dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtores dhe ta dënoj sipas ligjit duke aplikuar nenin 69 dhe 70 të KPRK-së përkitazi me rrethanat lehtësuese dhe rënduse.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprat penale për të cilat akuzohet dhe ka shtuar se ndihet i penduar mirëpo këtë e ka bërë për shkak të sjelljeve të palës së tretë C. G. i cili ky dhe personat e tjerë të familjes së tij vazhdimisht e prejnë pyllin të cilin e ka marr në shfrytëzim nga Qeveria e Kosovës-Agjensioni i Pyjeve, mirëpo të njëjtit vazhdimisht e prejnë pyllin edhe përkundër denoncimeve të shpesht të njëjtit nuk kuptojnë. Nuk ka pasur ndonjë qëllim ta lëndoj ndokënd por tia bëjë me dije se pylli të cilin e ka marr në shfrytëzim nuk bënë të dëmtohet me prerje ilegale. Poashtu armën e gjuetisë e ka pasur me leje të cilën i ka skaduar leja por të cilën nuk e ka parë se i ka skaduar afati. E ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë ngase është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ndihet i penduar dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do ta përsëriti këtë sjellje në të ardhmen, duke kërkuar që ti shqipton një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimin e ka bërë me vullnet dhe pas konsultimit me të ku paraprakisht ia ka shpjeguar benefitet që i parasheh ligji me rastin e pranimit të fajësisë dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke qenë se i mbrojturi i tij është mbajtës i familjes dhe pyllin e marrur me qira dhe e ka për mbajtjen e familjes së tij, duke konsideruar se të vetmin qëllim e ka pasur që ta mbrojë pyllin i cili është pronë e shteti nga prerja ilegale e nuk ka pasur për qëllim as të përdorë armë apo të kanos për këtë çështje, andaj me pajtim me qëllimin e dënimit, me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij e ka lutur gjykatën që gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe të vendos për një vendim minimal.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftushëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i forcës, kërcënimeve apo premtimeve, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet.

Matja dhe caktimi i dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprave penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprat penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, rrethanat personale dhe familjari se i njëjti është mbajtës i familjes, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin, pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nën minimumin e dënimit të parapar konform nenit 71 par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, duke aplikuar dënimin me kusht edhe për veprën penale për të cilën parashihet dënimi mbi 5 vite burgim, duke qenë e bindur gjykata se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 20-€ u caktua në emër të paushallit gjyqësor në bazë të ndërlikshmërisë së rastit, ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa për konfiskim

Vendimi për konfiskim e sendit-armës u bazua në nenin 367 par. 3 të KPRK-së, pasi që sendi-arma është mjetë me të cilin është kryer vepra penale.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN
P.nr.163/23 dt.24.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Gentiana Dakaj

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditë nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:003799
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05624291